



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 6 qershor 2013

**Fillimi i projektit tuining të financuar nga BE-ja:  
“Prodhimi bujqësor organic dhe mbrojtja e cilësisë së  
produkteve bujqësore”  
(Qendra Informative e BE-së)**

Fjalim nga  
Ambasadori Aivo Orav  
Shef i Delegacionit të BE-së

**I nderuari Ministër Dimovski,**

**I nderuari Ambasador Cristiani, z. Montanari,**

**Zonja dhe zotërinj**

Kam kënaqësinë të shpall fillimin e projektit tuining ë financuar nga BE-ja, i cili përkrah sektorin e bujqësisë.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian me vlerë prej 690.000 euro dhe është pjesë e përpjekjeve tona për të përshtatur sektorin bujqësor ashtu që të përputhet në anëtarësimin e plotë të BE-së. Shteti Anëtar i BE-së që është partner i këtij projekti tuining, është Ministria italiane e Bujqësisë, Udhqimit dhe Politikës së Pyjeve – një partner me përvojë të madhe në bujqësinë organike dhe mbrojtjen e cilësisë.

Cilësia është çështje që duhet të interesojë çdo bujk dhe çdo blerës, qoftë nëse flasim për komoditetet që prodhohen për të plotësuar standardet elementare apo për produktet e shtrenjta me cilësi të lartë, me të cilat Evropa dallohet se i bën jashtëzakonisht mirë.

Ligji i BE-së definon kërkesa të rrepta që garantojnë standarde për të gjitha produktet evropiane. BE-ja inkurajon shumëllojshmërinë ë produkteve bujqësore, mbrojtjen e emrave të produkteve nga keqpërdorimi dhe imitimi, si dhe u ndihmon konsumatorëve duke u dhënë informata që kanë të bëjnë me karakterin specific të produkteve.

Bujqësia organike është sector i bujqësisë evropiane, i cili ka shënuar zhvillim të vazhdueshëm gjatë viteve të fundit. Kërkesa gjithnjë e më e madhe e konsumatorëve për ushqim organik, ka krijuar mundësi të shumta për të gjitha pjesët e zinxhirit të furnizimit ushqimor.

Për shkak të natyrës së bujqësisë organike, janë krijuar një numër jashtëzakonisht i madh i vendeve të punës për popullatën rurale dhe pasurinë rurale.

Si rezultat i kësaj, sektori vendor i bujqësisë, i karakterizuar me ferma me intensivitet të vogël dhe të madh të fuqisë punëtore, ka përparësi efikase në këtë fushë. Mirëpo, në mënyrë që të prodhohen produkte organike me cilësi të lartë, të cilat gjithnjë e më tepër kërkohen nga konsumatorët vendorë dhe të BE-së, ekziston nevoja për operatorë të profesionalisht të trajnuar dhe me dije në fushën e bujqësisë, përpunimit dhe etapat e tjera të zinxhirit të prodhimeve.

Ky projekt do të kontribuojë për forcimin e këtyre kapaciteteve dhe do të inkurajojë shumëllojshmërinë dhe vlerën e shtuar të prodhimtarisë bujqësore në dobi të prodhuesve, përpunuesve dhe konsumatorëve bujqësorë.

Ju dëshiroj punë të mbarë në realizimin e synimeve të projektit.

Ju faleminderit shumë për vëmendjen!